



# PLAN

për zhvillim të qëndrueshëm.

Shtylla IV / 1

## TRAJTIMI I MUNGESËS SË ENERGJISË

Analizë politikash në mbështetje të  
procesit të elaborimit të SKZH-së

Zyra për Planifikim Strategjik  
e Zyrës së Kryeministrit





# PLAN

për zhvillim të qëndrueshëm.

Shtylla IV / 1

## TRAJTIMI I MUNGESËS SË ENERGJISË

Analizë politikash në mbështetje të  
procesit të elaborimit të SKZH-së

Zyra për Planifikim Strategjik  
e Zyrës së Kryeministrit

.....

## Përmbajtja

Lista e shkurtesave .....	4
Thekset kryesore nga kjo analizë .....	5
Qëllimi .....	6
Arsyetimi .....	6
Vlerësimi i gjendjes .....	6
Burimet e energjisë .....	6
Kapacitetet e tanishme të prodhimit të energjisë .....	7
Burimet e mundshme të prodhimit të energjisë .....	8
Politikat e tanishme .....	9
Definimi i problemit.....	11
Strukturat e konsumit .....	11
Kapacitetet për gjenerimin e energjisë elektrike.....	12
Humbjet në sistemin e shpërndarjes .....	13
Burimet e energjisë së ripërtëritshme.....	14
Efiçienca e energjisë.....	15
Rekomandimet lidhur me masat kryesore të politikave .....	16
Masa #4.01.1 Kapacitete ekonomike dhe ekologjike të gjenerimit të energjisë elektrike .....	16
Masa #4.02.2 Treg të hapur dhe konkurrues të energjisë .....	17
Masa #4.01.3 Konsum të ulët dhe përmirësim të efiçencës së energjisë .....	17
Masa #4.01.4 Shfrytëzim të matur të burimeve të ripërtëritshme të energjisë .....	18

.....

## **Lista e shkurtesave**

ZRRE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
ESCO	Kontratat për Performancën e Kursimeve të Energjisë
HEC	Hydrocentral
KEDS	Kompania për Shpërndarje dhe Furnizim me Energji në Kosovë
AKEE	Agjencia e Kosovës për Efiçencë të Energjisë
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KOSTT	Sistemi dhe Operatori i Tregut për Transmisionin e Energjisë në Kosovë
PKVEE	Plani Kombëtar i Veprimit për Efiçencë të Energjisë
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
BRE	Burimet e Ripërtërishme të Energjisë
ZPS	Zyra për Planifikim Strategjik
TC	Termocentral

---

## Thekset kryesore nga kjo analizë

- *Kapacitetet e prodhimit të energjisë në Kosovë janë të bazuara në qymyr, i cili furnizon rreth 97% të prodhimit të përgjithshëm të energjisë, me kapacitete operationale të prodhimit prej 1,000 MW. Burime tjera fizibile të prodhimit të energjisë në Kosovë përfshijnë: hidro, erë dhe energji tjera të ripërtëritshme, për të cilat Kosova është përkushtuar të prodhojë 29.47% të konsumit të përgjithshëm të energjisë deri më 2020.*
- *Tri dimensione sociale duhet të arrihen me rastin e definimit të problemit të energjisë në Kosovë: i besueshëm, i qëndrueshëm dhe i përballueshëm.*
- *Adresimi i problemit të energjisë duhet të shtrohet në: opsione të kufizuara të furnizimit, humbje të mëdha sistematike, shkalla e ulët e inkasimit dhe rritja e kërkesës për energji.*
- *Kapacitetet ekonomike dhe ekologjike të prodhimit të energjisë mund të arrihen duke shtyrë mbylljen e termocentralit Kosova A deri më 2021, të rehabilitojë Kosovën B deri në vitin 2018 si dhe të ndërtojë Kosovën e Re me kapacitete të prodhimit prej të paktën 1,000 MW.*
- *Treg i hapur dhe konkurrues komplementar i energjisë me Shqipërinë për të fuqizuar rrjetin transmetues të interkoneksionit të energjisë dhe ndërtuar kapacitete rezervë të pompimit.*
- *Ulja e konsumit dhe përmirësimi i efikasitetit të energjisë mund të arrihen duke krijuar një fond kombëtar për efikasitet dhe duke shfrytëzuar stimuj përmes Kontratave të Performancës së Kursimit të Energjisë deri më 2018.*
- *Shfrytëzimi i mençur i BRE mund të arrihet duke vendosur një synim më të vogël të pjesës së BRE si raport i prodhimit të përgjithshëm të energjisë, ndërtimin i hidrocentralit të Zhurit, shfrytëzimi i mençur i mbetjeve organike për plehërimin e tokës dhe rregullimi i tarifave të tregut të energjisë së biomasës.*

---

## Qëllimi

Qeveria e Kosovës ka iniciuar punën në hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (SKZH), Kosova 2020. SKZH e Kosovës është një dokument kryesor për vizionin strategjik për zhvillimin e vendit deri në vitin 2020. Ai prioritetizon politikat me qëllim të arritjes së progresit të prekshëm në fushat të cilat pengojnë rritjen ekonomike dhe kohezionin social. Modeli i rritjes ekonomike dhe kohezionit social për Kosovën, i shtjelluar nga ky projekt ka dalë me një listë të prioriteteve potenciale të politikave të cilat janë drejtpërdrejt të lidhura me objektivin strategjik të arritjes së normave vjetore të rritjes prej 7-8% deri në vitin 2020 duke zhbllokuar potencialin ekonomik të punës dhe burimeve natyrore në mënyrë që të maksimizohet prodhimi dhe të zbutet varfëria. Lista e lartpërmendur e prioriteteve të politikave është bazuar në analizën mbi pengesat për zhvillim ekonomik të Kosovës dhe është harmonizuar me prioritetet nga reformat strukturore të identifikuara në kuadër të Programit të Reformave Ekonomike të Republikës së Kosovës.

## Arsyetimi

### Vlerësimi i gjendjes

Sektori energjetik i Kosovës është një prej politikave më të debatuar, ndërsa nga studime të ndryshme furnizimi i qëndrueshëm me rrymë është identifikuar si një prej pengesave për rritje ekonomike. Energjia është një parakusht themelor për suksesin e një ekonomie moderne konkurruese. Stabiliteti me furnizim të qëndrueshëm dhe të sigurt të energjisë, burime të qëndrueshme dhe të përballeshme të energjisë, shpërndarje dhe konsum eficientë përbëjnë aspektet qendrore të strategjisë së vendit për sektorin e energjisë.

Sektori i energjisë përbënë ndër shtyllat kryesore që mundëson zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Objektivat kryesore të sektorit të energjisë janë:

- Të ketë energji të mjaftueshme për nevojat e Kosovës,
- Çmimet e energjisë të jenë të përballeshme për qytetarët dhe bizneset,
- Të mbrohet ambienti dhe të shfrytëzohen resurset në mënyrë efikase,
- Të ngritën investimet private dhe krijohen vende të reja të punës.

Furnizimi i energjisë cilësore dhe me çmime të përballeshme kanë qenë prioritete të larta të qeverisë në vitet e fundit, duke marrë parasysh ndikimin e drejtpërdrejtë të tyre në zhvillimin ekonomik dhe jetën e qytetarëve. Zhvillimi i sektorit të energjisë është element kyç për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit dhe investimet e huaja.

### Burimet e energjisë

Konsumi i produkteve të energjisë elektrike për qëllime të energjetike ose jo-energjetike paraqet një mori të gjerë burimesh të energjisë për periudhën 2011-2013. Përderisa Kosova është e pasur me thëngjill dhe prodhimi i energjisë kryesisht është i bazuar në këtë burim, produktet më të shfrytëzuara të konsumit të energjisë janë produktet e karburanteve. Tabela më poshtë paraqet konsumin e të gjitha produkteve e energjisë (në ktoe) për periudhën 2011-2013




Figura 1 - Të gjitha produktet konsumuara të energjisë për periudhën 2011-2013 Burimi: MZHE, Bilanci i energjisë 2014

Me 42.6%, produktet e naftës përfaqësojnë produktin më të konsumuar të energjisë gjatë periudhës së analizuar. Kosova është 100% e varur nga importi sa i përket karburanteve të lëngëta dhe produkteve të naftës. Energjia elektrike radhitet në vendin e dytë, duke mbuluar 30.5% të konsumit, biomasa mbulon 18.8%, qymyri mbulon 7.4%, ngrohja e fituar mbulon 0.6% dhe energjia solare me 0.1%.

#### Kapacitetet e tanishme të prodhimit të energjisë

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) – si kompani publike – me dy Termocentrale Kosova A dhe Kosova B, si dhe minierat e qymyrit (Sektori minerar jug-perëndim; Minierat e reja Sibovc dhe Sitnica) përbënë shtyllën kryesore të prodhimit të energjisë në Kosovë.

Krahas prodhimit të energjisë elektrike, KEK është përgjegjës për prodhimin, transportimin, ndarjen dhe ruajtjen e qymyrit. Divizioni për prodhimin e qymyrit ka rreth 3,600 punëtor. Qeveria, KfW dhe KEK kanë investuar bashkërisht një shumë prej 170 mil Euro për hapjen e një miniere të re, e cila ka mundur vazhdimin dhe rritjen e nivelit të prodhimit të qymyrit dhe prodhimin e energjisë elektrike. Gjithashtu, prodhimi i qymyrit në Minierën e Sibovcit ka filluar në vitin 2010, ndërsa vetëm në vitin 2013 janë prodhuar 7.4 milion tonelata nga kjo minierë. Aktualisht është aktive Miniera e Sitnicës dhe në vitin 2013 ka prodhuar 0.8 milion tonelata qymyr.

Kapacitetet e instaluar të termocentraleve të bazuara në qymyr, Kosova A dhe Kosova B gjenerojnë 1,478 MW. Megjithatë, për shkak të vjetërsisë së tyre, kapaciteti operacional i tyre është 1,000 MW.

Termocentrali Kosova A është ndërtuar në fillim të viteve 60-ta dhe 70-ta. Ai përbëhet nga njësitë A1 – A5, ndonëse njësitë A1 dhe A2 janë mbyllur vite më parë. Njësitë A3 – A5 janë funksionale dhe arrijnë kapacitet të shfrytëzimit në përafërsisht 50%, ndërsa që nga Qershori 2014 vetëm A3 është funksional për shkak të prishjeve teknike dhe eksplodimit. Sipas KEK-ut, për aspekte të sigurisë është e nevojshme që njësitë të operojnë me një kapacitet të zvogëluar prej përafërsisht 50-70% të produktit nominal të tij (200/210 MW).

Termocentrali Kosova B është ndërtuar në periudhën 1984/85 dhe përbëhet nga njësitë B1 dhe B2 me kapacitete të instaluar të gjenerimit prej 339 MW për secilin. Operimi i tij është penguar nga problemet e përsëritura teknike dhe një riparim i madh i të dy njësive është planifikuar gjatë viteve

2016/2017 për të siguruar funksionim të duhur gjatë viteve të ardhshme.

**Tabela 1 - Kapacitetet e instaluara të energjisë elektrike, statusi operacional i termocentraleve të bazuara në qymyr.**

Njësia	Kapacitetet e instaluara të gjenerimit (MW)	Neto (MW)	Periodha e ndërtimit	Fillimi i funksionimit	Gjendja
A1	65		1960 - 1962	21.10.1962	Jashtë funksionit
A2	125		1962 - 1965	20.05.1965	Jashtë funksionit
A3	200	182	1966 - 1970	18.04.1970	Në funksion
A4	200	182	1967 - 1971	15.05.1971	Në funksion
A5	210	187	1971 - 1975	08.07.1975	Në funksion
B1	339	310		1983	Në funksion
B2	339	310		1984	Në funksion
<b>Σ</b>	<b>1,288</b>	<b>1,171</b>			

Burimi: MZHE

Krahas qymyrit, por në një nivel më të vogël, energjia elektrike në Kosovë po ashtu prodhohet nga kapacitetet e hidroenergjisë, përkatësisht përmes Ujmani, Lumbardhi, Radaci, Dikanci, dhe Burimi. Kapaciteti i përgjithshëm i instaluar është rreth 42.58 MW, por vetëm një pjesë e këtij kapaciteti mund të shfrytëzohet në çdo moment të caktuar. Era po ashtu shfrytëzohet për gjenerim të energjisë elektrike, por kapaciteti i instaluar është vetëm 2MW.

**Tabela 2 - Hidrocentralet dhe energjia nga era**

Hidrocentralet	Të instaluar (MW)	Neto (MW)	Fillimi i funksionimit
HC Ujmani	35	32	1983
HC Lumbardhi	8.8	8	1957 (2006)
HC Dikanci 1	1	0.94	1957 (2010)
HC Radavci	0.9	0.84	1934 (2010)
HC Burimi	0.86	0.8	1948 (2011)
<b>Totali i Hidrocentraleve</b>	<b>46.56</b>	<b>42.58</b>	
<b>Energjia nga Era</b>	1.35		2010

Burimi: MED

#### **Burimet e mundshme të prodhimit të energjisë**

**Qymyri (linjiti)** është burimi më i rëndësishëm për Kosovën. Qymyri furnizon rreth 97% të totalit të prodhimit të energjisë elektrike dhe është metoda më pak e kushtueshme e prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë. Kosova renditet në vendit e tretë në Evropë për rezervat e linjtit dhe llogaritet të ketë rreth 12 miliardë tonë të rezervave gjeologjike me 10 miliardë tonë që ka fuqi kalorike më tepër se 5.450 kJ/kg (shiko tabelën 3).



Tabela 3 - Rezervat e Qymyrit (linjtit)

	Rezervat (t)		
	Gjeologjike	Me tepër se 5450 kJ/kg fuqi kalorike	Me pak se 5450 kJ/kg Fuqi kalorike
Bazeni i Kosovës	10,091,000,000	8,772,000,000	1,319,000,000
Bazeni i Dukagjinit	2,244,830,000	2,047,700,000	197,130,000
Bazeni i Drenicës	106,631,000	73,188,000	33,443,000
<b>Totali</b>	<b>12,442,461,000</b>	<b>10,892,888,000</b>	<b>1,549,573,000</b>

Burimi: MZHE

**Karburantet e lëngëta** – Kosova nuk ka rezerva të dokumentuara të naftës, gazit ose karburanteve të tjera të lëngëta që mund të shfrytëzohen si burime të prodhimit të energjisë dhe të gjitha produktet e naftës importohen – kryesisht nga Shqipëria dhe Greqia përmes Maqedonisë. Një termocentral i bazuar në karburante mund të furnizohet përmes Maqedonisë ose mundësisht përmes transportit rrugor nga porti i Durrësit, Shqipëri. Sikurse në rastin e centralit me gaz, blerja e karburanteve mund të kërkojë financime të mëdha të jashtme duke përkeqësuar edhe më tutje bilancin e tanishëm të llogarisë.

**Gazi natyror** – Kosova nuk ka burime të gazit natyror, por as sistem të zhvilluar të transmissimit të gazit. Importimi i gazit për prodhimin e energjisë mund të kërkojë investime në tubacionet e rrjetit dhe lidhjen e tij me Maqedoninë, Shqipërinë ose Serbinë, Nishin, për ta lidhur me Prishtinë dhe lokacionet e termocentralit të Obiliqit. Projekti i TAP-it eventualisht do të jetë operacional në vitin 2020, që paraqet një problem kohor për nevojat e pazgjdhura të Kosovës të furnizimit me energji pas dekomisionimit të TC Kosova A.

**Era** - një studim i vitit 2010 i realizuar nga NEK Technologies (Swiss Renewable Energy and Energy Efficiency Promotion) ka konkluduar se ekzistojnë shumë pak zona në Kosovë me shpejtësi të erës që tejkalojnë 6 m/s, që përbënë minimumin e nevojshëm për potenciale komerciale. Për më tepër, raporti ka konkluduar se burimet e erës në Kosovë janë mesatare. Qeveria përmes KfW është duke financuar krijimin e Atlasit të Erës për Kosovën, i cili po ashtu do të përfshijë komponentin e energjisë diellore (solare).

**Uji dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë** – sa i përket zhvillimit të energjisë së ripërtëritshme nga uji, një studim tjetër është realizuar për të identifikuar kapacitete për Hidrocentrale të vogla, i cili ka identifikuar 77 lokacione, me kapacitet prej 128, 197 MW. Me përkrahjen financiare të Bankës Botërore është në proces një projekt për përditësimin e studimit të fizibilitetit për ndërtimin e Hidrocentralit të Zhurit.

**Biogazi dhe Biomasa** – biogazi nga baza organike nga kafshët është i disponueshëm në shumë pjesë të Kosovës, megjithatë është i shpërndarë në tërë vendin dhe grumbullimi në një lokacion të caktuar do të ishte i kushtueshëm. Biomasa në formën e produkteve malore është një burim i mundshëm i gjenerimit të energjisë elektrike. Vlerësohet që ky burim ka potencial prej 120 GWh/për vit për periudhën afatmesme. Megjithatë, këto burime kanë shfrytëzim alternativë për ngrohje (druri dhe mbetjet e drurit) dhe për plehërimin e tokës (mbetjet organike), që i bënë të shtrenjta si burime të energjisë.

### Politikat e tanishme

Në nivelin e qeverisë, janë dy ministri që ndikojnë në debatin rreth sektorit të energjisë. Ministria e Zhvillimit Ekonomik nga konteksti i kapaciteteve të gjenerimit të energjisë (KEK është nën përgjegjësinë e kësaj Ministrie) dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nga perspektiva standardeve mjedisore dhe kursimit të energjisë.

Një numër organizatash ndërkombëtare dhe donatorë janë aktivë në sektorin e energjisë në Kosovë,

.....

me theks të veçantë Komisioni Evropian, Banka Botërore, USAID, KfW dhe të tjera. Po ashtu grupe të shoqërisë civile dhe OJQ kanë formuar një zë të fuqishëm duke influencuar debatin rreth sektorit të energjisë, ku asociacioni më i spikatur është Konsorciumi i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID). Ata avokojnë fuqishëm për masa të efijencës dhe BRE, si zëvendësim i kapaciteteve të reja të energjisë dhe po ashtu kanë prezantuar një studim që prezanton këtë pikëpamje.

Gjatë kohëve të fundit janë bërë ndryshime të shumta pozitive që kontribuojnë në krijimin e një mjedisi të shëndoshë në sektorin e energjisë. Ndër arritjet kryesore mund të theksohen:

- 18% rritje të prodhimit të energjisë elektrike nga termocentralet ekzistuese nga 4,527 GWh për vitin 2008 në 5,314 GWh për vitin 2013
- Ulja e humbjeve komerciale nga 25.8% gjatë vitit 2008 në 19.5% gjatë vitit 2013
- Ulja e humbjeve teknike nga 18% gjatë vitit 2009 në 16% gjatë vitit 2013
- Ngritja e faturimit nga 71% në vitin 2009 në 89.5% në vitin 2013
- Privatizimi i KEDS-it me një marrëveshje për investime të vlefshme prej 300 milion Euro për uljen e humbjeve teknike dhe komerciale në shpërndarjen e energjisë elektrike
- Miratimi i ligjeve dhe procedurave që nxisin investimet private në energjinë e ripërtëritshme
- Miratimi i Ligjit për Efijencën e Energjisë, Plani i Veprimit për Efijencën e Energjisë, dhe krijimi i një fondi investues nga institucionet ndërkombëtare financiare.

Qeveria ka përgatitur dhe miratuar dokumente të ndryshme strategjike të cilat janë relevante për sektorin. Ekziston Strategjia për Energjinë në Kosovë 2009-2018, një përmbledhje e synimeve të së cilës është si në vijim:

1. Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm me energji
2. Ristrukturimi dhe zhvillimi i sektorit të energjisë në përputhshmëri me Traktatin e Komunitetit të Energjisë (TKE)
3. Zhvillimi dhe rehabilitimi i kapaciteteve të gjenerimit të energjisë nga linjiti
4. Zhvillimi i infrastrukturës së transmisionit të energjisë
5. Zhvillimi i infrastrukturës së rrjetit të shpërndarjes së energjisë
6. Promovimi i investimeve të huaja në sektorin e energjisë
7. Rritja e shfrytëzimit të të gjitha burimeve të disponueshme të energjisë, duke përfshirë burimet e brendshme dhe të importuara
8. Promovimi i vetëdijesimit të mbrojtjes së mjedisit në aktivitetet e energjisë
9. Sigurimi i shfrytëzimit efikas të energjisë dhe promovimi i shfrytëzimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë
10. Zhvillimi i infrastrukturës së rrjetit të gazit.

Në fushën e efijencës së energjisë është miratuar Ligji për Efijencën e Energjisë dhe është krijuar Agjencia e Kosovës për Efijencë të Energjisë në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe qeveria ka miratuar Planin e Dytë Kombëtar për Efijencën e Energjisë në Kosovës 2013-2015 që përfshinë masa në këto fusha:

1. Sektori i linjtit
2. Sektori gjenerimit të energjisë elektrike
3. Sektori i transimisionit
4. Sektori i shpërndarjes së energjisë elektrike
5. Sektori i ngrohjes

Një Strategji për Ngrohjen 2011-2018 është miratuar nga qeveria. Strategjia ka përcaktuar këto objektiva kryesore:

1. Ulja e përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje, duke zhvilluar sistemet e ngrohjes qendrore;
2. Krijimi i kushteve për përdorimin e burimeve alternative të energjisë dhe BRE-ve për ngrohje, duke ndikuar pozitivisht në mbrojtjen e ambientit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit;
3. Krijimi i kushteve për përdorimin e pajisjeve efikente për ngrohje, si dhe ngritjes së performancës termike të stokut të ndërtesave.

### Definimi i problemit

Qeveria është e përfshirë thellësisht në sektorin e energjisë, me pronësi të akterëve kryesor (KEK, KOSTT, KEDS privat), funksionet rregullative, si dhe mbikëqyrjen e dimensionit social për shkak të rritjes së vazhdueshme të çmimeve të energjisë elektrike. Qeveria duhet të balancojë konfliktet e ndryshme të interesit në këtë sektor. Energjia duhet të jetë:

1. E sigurtë – bilanci ndërmjet kërkesës dhe ofertës për të garantuar siguri të energjisë elektrike në vend<sup>1</sup>, të parandalohen reduktimet e energjisë elektrike dhe plotësohen kërkesat e pikut
2. E qëndrueshme – zvogëlimi i efekteve negative të konsumit të tepërt të energjisë (eficienca e energjisë) dhe po ashtu të merren parasysh efektet anësore (ndikimi mjedisor dhe shëndetësor),
3. E përballueshme – çmimet të mbahen në një nivel në atë mënyrë që konsumatorët të kenë mundësi të mbulojnë nevojat e tyre për energji elektrike dhe nuk bien në kurthin e varfërisë në energji

Nëse vetëm një prej këtyre aspekteve mbizotëron, do të ketë ndikim negativ në dy të tjerat, prandaj është e nevojshme një qasje e matur si dhe të konsiderohen nevojat e të gjithë hisedarëve në procesin e formësimit të politikave në këtë fushë (investitorët/operatorët, konsumatorët dhe mbrojtja e mjedisit).

### Strukturat e konsumit

Kërkesa për energji elektrike ka një trajektore në rritje që është e ndërlidhur me rritjen ekonomike. Parashikimet e Bankës Botërore theksojnë një rritje të dukshme të kërkesës për energji elektrike, që gjithashtu paraqiten në “skenarë të ulët”. Këto kalkulime tashmë marrin parasysh uljen e kërkesës së shkaktuar si pasojë e rritjes së çmimeve, uljes së humbjeve në shpërndarje në një nivel të pranueshëm dhe masat e aplikuar të eficientës së energjisë.




Figura 2 - Kërkesa për energji elektrike (GWh)

Burimi: Banka Botërore

Edhe nëse do të zhvillohen burime të tjera të gjenerimit të energjisë elektrike, studimi i Bankës

<sup>1</sup> Siguria e energjisë elektrike është përcaktuar nga margjina e kapacitetit rezervë në tejkallim të kërkesës maksimale të energjisë elektrike dhe kjo duhet të mbahet në përafërsisht 20%

Botërore<sup>2</sup> po ashtu tregon se hendeku i tanishëm në furnizimin me energji elektrike do të bartet edhe në të ardhmen (disa projekte të energjisë nga era me kombinim të kapaciteteve të instaluar prej 257 MWh, hidrocentrale të vogla me kapacitete të kombinuara prej 60 MWh, Hidrocentrali i Zhurit me kapacitete të instaluar prej 305 MWh, dhe termocentrali i ri me kapacitete të instaluar prej 560 MW si zëvendësim për dekomisionimin e TC Kosova A. Nuk është reale të pritet që Kosova do të ketë mundësi të përmbushë kërkesën në rritje me burimet e tanishme të energjisë, por analizat tregojnë se kapaciteti i planifikuar për prodhim është i pamjaftueshëm. Varësia në eksport – aktualisht në rreth 12% (ndërmjet 5 dhe 17% në saje të kërkesës sezonale) – do të vazhdojë të paraqes një kërcënim për sigurimin e energjisë në vend.




Figura 3 - Bilanci i Energjisë së Kosovës (GWh)

Burimi: Banka Botërore

### Kapacitetet për gjenerimin e energjisë elektrike

Në shumë studime, qasja në energji elektrike është identifikuar si një pengesë e pashmangshme për rritjen ekonomike (p.sh. OEK, Diagnostifikimi i Rritjes Ekonomike). Anketa për Ndërmarrësi e vitit 2009 ka identifikuar mungesën e sigurimit të energjisë elektrike si pengesa primare e të bërit biznes në Kosovë. Një studim tjetër i publikuar kohëve të fundit nga USAID (2012) ka vlerësuar se furnizimi i pasigurtë me energji elektrike në Kosovë iu shkaktonë kosto vjetore bizneseve në shumë prej 260 milion Euro. Shqyrtimi i këtyre humbjeve nga perspektiva e të ardhmes dhe krahasimi i tyre me shitjet vjetore në Kosovë përbëjnë 7.3%, që është dukshëm më e lartë krahasuar me 0.1% në Slloveni, 0.8% në Malin e Zi ose 2.6% në Shqipëri.

Me alternativa të kufizuara të furnizimit, humbje të mëdha sistematike, shkallë të ulët të faturimit dhe kërkesë në rritje për energji elektrike, hendeku është duke u zgjeruar në atë masë ku produkti ekonomik do të stagnojë për shkak të mungesës së energjisë. Nëse nuk adresohet, kjo do të pengojë aktivitetin investues dhe do të kufizojë funksionimin normal të kompanive ekzistuese. Kosova është e varur në importet e energjisë elektrike, e cila duke marrë parasysh gjendjen relativisht jostabile në tërë rajonin, e vendosë vendin në pozitë të pafavorshme ndaj mungesës së jashtme të furnizimit dhe zhvillime të pasigurta të çmimeve.

Situata përkeqësohet nëse qeveria nuk ndërmerre veprime të menjëhershme, kapacitetet aktuale janë me teknologji të vjetruar dhe të prirura të dështojnë, asnjë kapacitet i ri nuk është duke u ndërtuar për momentin, çmimet mbahen të ulëta për të siguruar përballueshmërinë për konsumatorët, por nën nivelin e interesimit për investitor potencial, ndërsa humbjet në sistemin e shpërndarjes janë tepër të larta. Po

<sup>2</sup> Raporti: Zhvillimi dhe Vlerësimi i opsioneve të furnizimit me energji në Kosovë, 2011

.....

ashtu shqetësimet mjedisore vonojnë investimet publike në kapacitetet prodhuese. Sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, gjenerimi i energjisë me përmasa mjedisore është i mundshëm por teknologjia paraqet një element të rëndësishëm. Duke marr parasysh se është një prej fushave më të rëndësishme për rritje ekonomike dhe krijim të vendeve të punës, Qeveria duhet të përshejtojë investimet duke adresuar shqetësimet mjedisore sipas nevojës.

#### **Humbjet në sistemin e shpërndarjes**

Humbjet në transminion (tensionin e lartë, KOSTT) mbahen në nivel relativisht të pranueshëm (2%), që është e krahasueshme me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, humbjet në sistemin e shpërndarjes (tensionin e ulët, KEDS), janë shumë të larta (31%) dhe duhet të adresohen. Një pjesë e këtyre humbjeve mund t'i atribuohet faktorëve teknik (17%), ndërsa pjesa më e madhe ka të bëjë me humbjet komerciale (24%) që aktualisht janë duke u adresuar nga investitori privat KEDS.

Trajtimi i problemit të humbjeve ndikon pozitivisht në përbalueshmërinë e çmimeve të energjisë elektrike, numri i madh i lidhjeve ilegale rritë çmimin e konsumatorëve të tjerë. Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka reflektuar në marrëveshjen me KEDS lidhur me uljen e humbjeve në kalkulimin e tarifave – janë vendosur caqe vjetore për ulje, nëse caqet nuk arrihen, atëherë kompania e shpërndarjes do ta bartë koston, ndërsa nëse arrihet do t'i mundësohet të gjenerojë profit shtesë.

Një pjesë e këtij problemi parazitor është shkaktuar nga varësia e sistemit të shpërndarjes në rrjetin e energjetik të Serbisë në territorin e veriut të Kosovës. Edhe pse është çështje e ndjeshme, është e nevojshme që të adresohet në mënyrë urgjente (përmes mjeteve teknike – investimeve infrastrukturore), në atë mënyrë që KOSTT dhe KEDS të kenë mundësi të marrin përsipër shpërndarjen e energjisë në tërë territorin e Kosovës dhe të mënjanojnë humbjet e shumta komerciale që nuk mund të adresohen përmes mjeteve standarde (shkyçjen e konsumatorëve që nuk paguajnë).

#### **Kapaciteti i transminionit dhe konsumi maksimal**

Kërkesa për energji është e pa balancuar nga aspekti sezonal, me rritje të dukshme të konsumit gjatë muajve të dimrit. Kjo kryesisht rezulton për shkak të shfrytëzimit të madh të energjisë si burim i ngrohjes. Duke qenë se Kosova nuk ka kapacitete fleksibile të prodhimit për të përbushur kërkesat maksimale të konsumit, aktualisht kërkesa e lartë në dimër plotësohet përmes importit të energjisë.

Një projekt për të rritur kapacitetet e eksportit dhe importit ndërmjet rrjeteve të transminionit të Kosovës dhe Shqipërisë prej 400 kV ka filluar të implementohet. Lidhja e tensionit të lartë duhet të jetë e levërdishme për të dy shtetet, ngase kapacitetet gjeneruese të tyre janë komplementare. Shqipëria prodhon 98% të energjisë në hidrocentrale, me prodhim të paqëndrueshëm varësisht nga sezona dhe reshjet. Kosova ka një kapacitet të paluhatshtëm të prodhimit të zhvilluar për sigurimin e ngarkesës bazë së energjisë në rrjet. Si rrjedhojë të dy vendet janë të varura nga importi, edhe pse për arsye të ndryshme (Shqipëria për të stabilizuar ngarkesën bazë, Kosova për të plotësuar kërkesat maksimale për energji). Në këtë mënyrë rritja e kapaciteteve të interkoneksionit ndihmon të dy shtetet që në formë të natyrshme ta stabilizojnë mospërputhshmërinë furnizim-kërkesë. Gjithashtu, Shqipëria ka potencial për të zbutur kërkesën maksimale ditore të konsumit (gjatë ditës ndaj natës) përmes investimeve në pompat e rezervuarëve. Kosova po ashtu mund të përfitojë nga këto investime pas ndërtimit të kapacitetit të rrjetit të transminionit.

Një debat ka filluar nëse duhet të iniciohet një projekt për lidhjen me projektin e planifikuar të rrjetit të gazit (TAP), që do të kalojë përgjatë rajonit për të siguruar gazin në Evropë. Në rastin e Kosovës, e cila nuk ka infrastrukturë të zhvilluar të brendshme të gazit, gazi nuk mund të shërbehet për amvisëri për t'u shfrytëzuar si burim i ngrohjes, që në anën tjetër nuk qëndron për shumicën e vendeve të cilat kanë infrastrukturë të zgjeruar të gazit. Shfrytëzimi i mundshëm është i kufizuar për ndërmarrje në industri dhe prodhimtari (që aktualisht janë të pazhvilluara në Kosovë), ose prodhimin e energjisë nga

gazi natyror qoftë si burim primar ose si rezervë për projektet e energjisë së ripërtëritshme, sikurse era dhe/ose energjia diellore.

### Burimet e energjisë së ripërtëritshme

Një alternativë tjetër për të siguruar kapacitete të mjaftueshme të gjenerimit të energjisë elektrike është intensifikimi i shfrytëzimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka miratuar një Udhëzim Administrativ lidhur me caqet e BRE-së deri në vitin 2020. Këto caqe janë në përputhshmëri me vendimin e Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë 2012/04/MC, dhe në përputhshmëri me Udhëzimin Administrativ për zbatimin e caqeve sipas direktivës së BE-së 2009/28/EU. Këto caqe janë pjesë e Planit Kombëtar për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë 2011-2022, i hartuar sipas metodologjisë së Komunitetit të Energjisë.

Kosova është zotuar të prodhojë 25% të bruto konsumit përfundimtar të energjisë nga BRE deri në vitin 2020 dhe ka madje fuqizuar këtë përkushtim me caktimin e një caku vullnetar prej 29,47%. Me nivelin e tanishëm prej nën 5% dhe pa ndonjë projekt domethënës për BRE, këto nivele nuk janë reale. Edhe po që se është marrë parasysh potenciali gjenerimit të energjisë nga BRE të përshkruar në studimin e Bankës Botërore mbi opsionet e gjenerimit të energjisë elektrike (Zhur, projekte të ndryshme të hidrocentraleve të vogla dhe energjisë nga era), niveli i BRE-së nuk do të arrinte 16% deri në vitin 2020.




Figura 4 - Energjia e prodhuar nga qymyri dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë (GWh)

Burimi: Vlerësimet e Bankës Botërore

Qeveria gjatë vendimmarrjes për përkrahjen e investimeve për BRE, duhet të marr parasysh sigurinë e furnizimit dhe çmimet e energjisë elektrike të prodhuar nga këto burime, të cilat pashmangmërisht do ta bëjnë çmimin e energjisë me pak të përballueshme. Burimet e ripërtëritshme nuk mund të kenë pjesëmarrje të madhe në prodhimin e përgjithshëm nëse çmimet mbahen në një nivel të arsyeshëm, ato vetëm mund të plotësojnë termocentralet konvencionale. Zyra e Rregullatorit të Energjisë tashmë ka vendosur tarifën për energjinë e gjeneruar nga uji. Edhe pse tarifën e caktuara janë relativisht të larta, nuk ka ndonjë interesim për energji nga era. Tarifën për energji nga biomasa dhe energji diellore janë duke u caktuar nga ZRRE.

Sipas studimeve të Bankës Botërore<sup>3</sup> dhe NEK Technologies ekziston një potencial i vogël për gjenerimin e energjisë nga era dhe një potencial shumë i kufizuar për gjenerimin e energjisë fotovoltike (solare) në Kosovë. Për më tepër, këto burime njëkohësisht do të kërkonin ndërtimin e kapaciteteve

<sup>3</sup> Zhvillimi dhe Vlerësimi i Opsioneve të Furnizimit me Energji në Kosovë, DH Infrastructure, Banka Botërore, 2012

rezervë në formën e termocentraleve konvencionale (nga linjiti ose gazi). Si rrjedhojë alternativat më të zbatueshme janë nga uji (hidro) dhe biomasa. Potenciali hidroenergjetik është shfrytëzuar deri në një masë, por ekzistojnë projekte të tjera të planifikuara, duke përfshirë Zhurin dhe disa hidrocentrale të vogla. ZRRE ka lëshuar leje për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla që arrijnë deri në 200 MW, por ndërtimi ka filluar vetëm në disa raste (20 MW të instaluar në përgjithësi).

Potenciali për energji nga biomasa është relativisht i lartë dhe konsiderohet të jetë i pashfrytëzuar në Kosovë. Alternativat tjera të përdorimit si ato të plehërimit të tokës dhe drunjtve për ngrohje paraqesin burimet më të përshtatshme për energjinë nga biomasa. Deri më tani, është diskutuar vetëm shfrytëzimi i shpërndarë i biomasës (jo i lidhur me rrjetin e transmisionit). Zhvillimi i biomasës si një burim real alternativë për prodhimin e energjisë dhe/ose për ngrohje kërkon qëndrueshmëri të furnizimit si një faktor kritik i suksesit.

### Eficienca e energjisë

Qeveria ka miratuar Ligjin për Eficiencë të Energjisë dhe gjithashtu Planin e dytë Kombëtar për Eficiencë të Energjisë 2013-2015. Është miratuar një synim indikativ për kursimet e energjisë prej 9%, në shumë prej 1021.08 ktoe deri në vitin 2018. Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë është themeluar në vitin 2012. Agjencia është duke zbatuar shumë projekte të mbështetur nga donatorë të jashtëm, që në total arrin shumën mbi 100 milion Euro. Shumica e këtyre projekteve adresojnë eficiencën e energjisë në ndërtesa publike, kryesisht përmes instalimit më të mirë.




Figura 5 - Pasqyra e shfrytëzimit të burimeve të energjisë në të gjithë sektorët (ktoe) për qëllime të energjisë elektrike.

Burimi: Bilanci i Energjisë 2014, MZHE

Në shqyrtimin e konsumit të energjisë sipas sektorëve, është e qartë se konsumi më i madh është në sektorin amvisërisë, duke vijuar me transportin dhe bujqësinë. Qeveria deri më tani ka adresuar sektorin e ndërtesave publike me përkrahje financiare nga donatorët, por gjithashtu riparimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i sistemeve të ngrohjes qendrore është trajtuar në Planin Kombëtar të Eficiencës së Energjisë. Sistemi i ngrohjes qendrore në Kosovë është i pazhvilluar, dhe paraqet një mundësi shumë të madhe për qeverinë për të adresuar eficiencën e energjisë por edhe për investitorët privat për të zhvilluar një linjë biznesi në shërbime. Aktualisht, vetëm Prishtina dhe Gjakova kanë sisteme të ngrohjes qendrore dhe shfrytëzimi i tyre është shumë i ulët. Kjo është rezultat i kufizimeve të ndryshme si pasojë

e teknologjisë së vjetërsuar. Së fundmi, projekti për përmirësimin e sistemit të ngrohjes në Prishtinë (Termokos) duke shfrytëzuar ko-gjenerimin nga TC Kosova B është implementuar me sukses dhe ka funksionuar gjatë tërë sezonës së dimrit.

## Rekomandimet lidhur me masat kryesore të politikave

### Masa #4.01.1 Kapacitete ekonomike dhe ekologjike të gjenerimit të energjisë elektrike

Qeveria është zotuar për **dekomisionimin e Termocentralit Kosova A**, i cili nuk i përmbush standardet mjedisore dhe funksionimi i tij është i pasigurtë. Sipas dakordimit me BE-në procesi duhet të përfundohet në vitin 2017, edhe pse ky afat nuk do të mund të arrihet për shkak të ngecjeve të dukshme në zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese që do të mund të zëvendësonin TC Kosova A.

Nëse TC Kosova A do të mbyllet pa krijimin e kapaciteteve alternative të gjenerimit, Kosova do të bëhet shumë e varur nga importi i energjisë elektrike, gjë që si rrjedhojë do të ngritë koston e energjisë për konsumatorët. Si alternativë, dekomisionimi i TC Kosova A është i mundshëm vetëm me krijimin e kapaciteteve të reja gjeneruese në mënyrë që të kompensohet humbja e nivelit të tanishëm të furnizimit. Në këtë mënyrë, Qeveria do të kërkojë të dakordohet me BE-në për **shtyrjen e afatit për dekomisionimin të këtij termocentrali deri në vitin 2021**.

Kosova B, sikurse Kosova A, nuk përmbush standardet mjedisore. Megjithatë, në rastin e **rehabilitimit të TC Kosova B** ka mundësi të arrihen standarde më të larta. BE është duke mbështetur këtë proces përmes mekanizmave financiar të saj. Rehabilitimi duhet të realizohet për secilën njësi ndaras gjatë periudhës 2017-2018, në mënyrë që të mënjanohen mungesa të mëdha të prodhimit të energjisë.

Duke marrë parasysh hendekun e dukshëm ndërmjet konsumit dhe prodhimit të planifikuar/vlerësuar të energjisë elektrike, që thellohet më tepër nga përkushtimi për çmontimin e TC Kosova A, nevoja për kapacitete të reja të gjenerimit të energjisë elektrike bëhet shumë urgjente. Sipas vlerësimit të Bankës Botërore qymyri (linjiti) është metoda më e lire për furnizimin me energji elektrike edhe pas konsiderimit të faktorëve mjedisor.

Përpjekjet e tanishme për të tërhequr investitorë privat për **ndërtimin e një Termocentrali të ri** (Kosova e Re) duhet të shpërfillen dhe qeveria duhet që menjëherë të lansojë një projekt të ri. Kosova e Re mund ndërtohet qoftë përmes investitorëve privat, ndonjë formë të PPP-së, ose eventualisht si një projekt qeveritar me mundësinë për të hyrë në një kontratë koncesioni për operim në një fazë të mëvonshme (ngjashëm me Aeroportin e Prishtinës). **Një rishikim i kapaciteteve të instaluar duhet të konsiderohet**, nga 600 MW të planifikuara, në 1000-2000 MW sikurse është diskutuar fillimisht. Kjo do të mundësonte shfrytëzimin të plotë të potencialit eksportues të Kosovës si rezultat i rezervave të mëdha të linjtit.

Tabela 4 – Masa #4.01.1: Kapacitete ekonomike dhe ekologjike të gjenerimit të energjisë elektrike

Aktiviteti	Produkti	Rezultati
Masa #4.01.1 <b>Kapacitete ekonomike dhe ekologjike të gjenerimit të energjisë elektrike</b>	Të shtyhet dekomisionimi i TC Kosova A deri në vitin 2021	Gjenerimi i energjisë elektrike përmbushë kërkesat e tregut
	Rehabilitimi i TC Kosova B deri në vitin 2018	Nuk ka mungesë të furnizimit me energji elektrike
	Ndërtimi i Termocentralit Kosova e Re me një rritje të kapacitetit të instaluar prej së paku 1000 MW, përmes Partneritetit Publiko Privat.	Firmat nuk e konsiderojnë energjinë elektrike si pengesë kryesor për investime
		Standardet mjedisore janë adresuar



Rritja e kapaciteteve do të ketë dy përparësi kryesore. Së pari, **standartet mjedisore është më lehtë të arrihen** në projekte më të mëdha (kosto më të ulët të pajtueshmërisë në krahasim me totalin e investimit), që mundëson kthim më të lartë në investime. Së dyti, **potenciali për eksport** mund të tërheqë investitorë me reputacion, duke qenë se çmimet e energjisë elektrike në tregun e brendshëm janë të rregulluara si pasojë e shqetësimeve të përballueshmërisë.

#### Masa #4.02.2 Treg të hapur dhe konkurrues të energjisë

Krahas zbatimit të Direktivave të BE-së (Pakoja e tretë e energjisë) për të krijuar një treg konkurrues të energjisë, një projekt i rëndësishëm për sigurimin e tregut të hapur të energjisë është **fuqizimi i rrjetit të transmisionit të energjisë elektrike me Shqipërinë**. Ky projekt është duke u zbatuar përmes KOSTT-it, por punët në pjesën e Shqipërisë duhet të përshpejtohen për të mundësuar shfrytëzimin e plotë të përfitimeve për të dy vendet. Krahas fuqizimit të kapacitetit të transmisionit ndërkufitar, Kosova duhet të arrij një marrëveshje me Shqipërinë për ndërtimin e kapaciteteve të pompave rezervë, që mund të ndihmojë në plotësimin e kërkesave maksimale të pambuluara nga kapacitetet gjeneruese të Kosovës.

Tabela 5 - Treg të hapur dhe konkurrues të energjisë

	Aktiviteti	Produkti	Rezultati
<b>Masa #4.02.2 Treg të hapur dhe konkurrues të energjisë</b>	Fuqizimi i rrjetit të transmisionit të energjisë elektrike me Shqipërinë	Rrjeti i transmisionit të energjisë elektrike i ndërtuar deri në vitin 2018	Eksporti i kapacitetit të tepruar të energjisë elektrike
	Ndërtimi i pompave për grumbullimin e ujit (rezervuarëve)	Pompat e rezervuarëve të ndërtuara deri në vitin 2022	Furnizim të qëndrueshëm të energjisë elektrike

#### Masa #4.01.3 Konsum të ulët dhe përmirësim të efijencës së energjisë

Donatorët janë duke kontribuar me shuma të mëdha financiare për rritjen e efijencës së energjisë në Kosovë. Qeveria, përveç në ndërtesat e sektorit publik, do t'i adresojë këto burime edhe në sektorin e banimit, që përbënë konsumin më të madh të energjisë në vend. Në mënyrë që të arrihen këto caqe, Qeveria do të **krijojë Fondin Kombëtar për Efijencë të Energjisë**, ku financat e donatorëve do të përputhen me alokimet e buxhetit vendor. Për të arritur këtë synim kërkohet ndryshimi i Ligjit për Menaxhimin e Financave publike.

Masat e financuara nga Fondi Kombëtar për Efijencë të Energjisë mund të përfshijnë:

- Subvencionimi i rindërtimit të sistemeve të ngrohjes qendrore në zona më të mëdha urbane
- Subvencionimi i masave të efijencës së energjisë lidhur me ndërtesat publike dhe infrastrukturën (ndryshimi i teknologjisë së ndriçimit të rrugëve për komunat)
- Subvencionimi për kalimin në një burim të përbashkët të ngrohjes për tërë shtëpinë (me përjashtim të energjisë elektrike) ose izolimin e shtëpive (kulmi, dritaret, muret) për shtëpi banimi
- Ofrimi i drejtpërdrejt ose përmes bankave komerciale, ofrimi i kredive të buta dhe garantimit të kredive për masa të Efijencës së Energjisë për amvisëri dhe /ose NVM
- Subvencionimi për instalimin e paneleve të vogla solare në çati për ngrohjen e ujit ose prodhimin e energjisë për amvisëri të caktuara dhe/ose NVM
- Subvencionimi i kalimit nga ngrohja përmes rrymës në burime të tjera të ngrohjes (ose zgjerimi i sistemit alternativ të ngrohjes në dhoma të tjera) për amvisëri dhe/ose NVM.
- Subvencione të vogla për shkëmbimin e pajisjeve shtëpiake me ato më efijente (kjo mund të përfshijë nga llambat e ndriçimit në aparate televizive) për amvisëri – që mund të arrihet përmes dyqaneve të autorizuara për mallra elektronike, nëse marrin një pajisje të vjetër në shkëmbim të blerjes së pajisjes së re.

Shfrytëzimi i **Kontratave të Performancës së Kursimit të Energjisë (ESCO)** duhet të inkurajohet në nivelin qendror dhe komunal.

**Tabela 6 - Masa #4.01.3 Konsum më të ulët dhe efikasitet të përmirësuar të energjisë**

Aktiviteti	Produkti	Rezultati
<p>Masa #4.01.3 <b>Konsum më të ulët dhe efikasitet të përmirësuar të energjisë</b></p> <p>Të krijohet Fondi Kombëtar për Efikasitet 2018</p> <p>Të shfrytëzohen Kontratat e Performancës së Kursimit të Energjisë në nivelin qendror dhe lokal të qeverisjes deri në vitin 2018</p>	<p>Fondi Kombëtar për Efikasitet i krijuar deri në fund të vitit 2018</p> <p>500 NVM dhe 1000 amvisëri të cilat përmirësojnë efikasitetin e energjisë përfitojnë nga subvencionet e energjisë</p> <p>25% të institucioneve të nivelit qendror dhe lokal përdorin Kontratat e Performancës së Kursimit të energjisë</p>	<p>Shfrytëzimi i energjisë për kokë banori ulët për 25%, deri në vitin 2022.</p>

#### **Masa #4.01.4 Shfrytëzim të matur të burimeve të ripërtëritshme të energjisë**

Potenciali për shfrytëzimin e BRE-së është relativisht i kufizuar në Kosovë, pjesërisht për shkak të pamundësisë së tyre ose kostos së lartë për konsumatorë, të shoqëruar me përfshirjen e tyre në ofrimin e energjisë elektrike nga burime alternative. Kështu, Qeveria duhet të negocioj një synim më të ulët për shfrytëzimin e BRE.

Sikurse në rastin e TC Kosova e Re, qeveria duhet të procedoj me ndërtimin e HC Zhuri qoftë përmes investitorit privat, ndonjë formë të PPP, ose eventualisht si projekt qeveritar me mundësinë për të hyrë në ndonjë kontratë koncesioni.

Për përkrahjen e zhvillimit të BRE-së, qeveria do të fokusohet në resurset e biomasës dhe të ofrojë mbështetje të synuar për fermerë që kanë kontrata afatgjata për shfrytëzimin e mbeturinave nga prodhimet organike si dhe sigurimin e organizimit më të mirë të tregut të drurit dhe mbeturinave malore. ZRRE do të caktojë tarifën për biomasë në një nivel që mundëson zhvillimin e projekteve të shkallës më të madhe të ndërlidhura me rrjetin e shpërndarjes, krahas shpërndarjes të vetëm burimeve gjeneruese.

**Tabela 7 - Masa #4.01.4 Shfrytëzim të matur të burimeve të ripërtëritshme të energjisë**

Aktiviteti	Produkti	Rezultati
<p>Masa #4.01.4 <b>Shfrytëzim të matur të burimeve të ripërtëritshme të energjisë</b></p> <p>Negocimi i caqeve më të ulëta për shfrytëzimin e BRE</p> <p>Ndërtimi i HC Zhuri përmes kontratës së PPP-së</p> <p>Subvencionimi i kontratave afatgjata për fermerë që shfrytëzojnë mbetjet organike</p> <p>Rregullimi i tarifave të tregut të biomasës</p>	<p>Caktimi i caqeve më të ulëta për shfrytëzimin e BRE</p> <p>Kontrata përmes PPP-së për ndërtimin e HC Zhuri të nënshkruar deri në vitin 2018, ndërtimi të finalizohet deri në vitin 2022</p> <p>500 fermerë që shfrytëzojnë mbeturinave organike përfitojnë nga subvencionimi afatgjatë deri në vitin 2022</p> <p>Caktimi i tarifave për tregun e biomasës</p>	<p>Pjesëmarrja e prodhimit e energjisë jokarbonike në energji dhe energji elektrike është rritur për 25% deri në vitin 2022</p>

Tabela 8 - Indikatorët për vlerësimin e progresit ne sektorin e energjisë

Aspekti	Indikator	Të dhënat e nevojshme
<b>Përballueshmëria e çmimeve</b>	Pjesëmarrja e të ardhurave të amvisërisë të shpenzuar në naftë dhe energji elektrike	Shpenzimet e të ardhurave të amvisërisë të shpenzuara në naftë dhe energji elektrike
<b>Ekonomik</b>	Shfrytëzimi i energjisë për kokë banori	Shfrytëzimi i energjisë (totali i furnizimit të energjisë, konsumi përfundimtar i furnizimit me energji dhe shfrytëzimi i energjisë elektrike) Popullata totale
<b>Efienca e furnizimit</b>	Eficienca e shfrytëzimit final, konvertimi dhe shpërndarja e energjisë	Humbjet në sistemin e transmisionit, duke përfshirë humbjet në gjenerimin e energjisë elektrike, transmision dhe shpërndarje
<b>Prodhimi</b>	Norma e rezervave ndaj prodhimit	Rezerva të rikuperueshme Prodhimi total i energjisë.
<b>Diversifikimi</b>	Pjesëmarrja e energjisë jokarbonike në energji dhe energji elektrike	Furnizimi primar, gjenerimi i energjisë elektrike dhe kapacitetet gjeneruese nga energjia jo-karbonike Totali i furnizimit me energji primare, totali i gjenerimit të energjisë elektrike dhe totali i kapaciteteve gjeneruese
<b>Siguria</b>	Vartësi në importimin neto të energjisë	Importet e energjisë Totali i furnizimit primar të energjisë
<b>Çmimet</b>	Çmimet e energjisë për konsumin final nga nafta dhe nga sektori	Çmimet e energjisë (me dhe pa taksa/subvencionimi).

## Tabela e figurave


<b>Figura 1 - Të gjitha produktet konsumuara të energjisë për periudhën 2011-2013</b> Burimi: MZHE, Bilanci i energjisë 2014.....	7
<b>Figura 2 - Kërkesa për energji elektrike (GWh)</b> .....	11
<b>Figura 3 - Bilanci i Energjisë së Kosovës (GWh)</b> Burimi: Banka Botërore .....	12
<b>Figura 4 - Energjia e prodhuar nga qymyri dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë (GWh)</b> Burimi: Vlerësimet e Bankës Botërore .....	14
<b>Figura 5 - Pasqyra e shfrytëzimit të burimeve të energjisë në të gjithë sektorët (ktoe) për qëllime të energjisë elektrike.</b> Burimi: Bilanci i Energjisë 2014, MZHE .....	15

## Lista e tabela

Tabela 1 - Kapacitetet e instaluar të energjisë elektrike, statusi operacional i termocentraleve të bazuara në qymyr.....	8
Tabela 2 - Hidrocentralet dhe energjia nga era.....	8
Tabela 3 - Rezervat e Qymyrit (linjtit).....	9
Tabela 4 – Masa #4.01.1: Kapacitete ekonomike dhe ekologjike të gjenerimit të energjisë elektrike.....	16
Tabela 5 - Treg të hapur dhe konkurrues të energjisë .....	17
Tabela 6 - Masa #4.01.3 Konsum më të ulët dhe efikasitet të përmirësuar të energjisë .....	18
Tabela 7 - Masa #4.01.4 Shfrytëzim të matur të burimeve të ripërtëritshme të energjisë .....	18
Tabela 8 - Indikatorët për vlerësimin e progresit në sektorin e energjisë.....	19

## Bibliografia

- Strategjia e Energjisë së republikës së Kosovës 2009-2018
- Studimi për ripërtrirjen e TC Kosova A - Siguri e Furnizimit të Energjisë në Kosovë, Bilfinger / Reliant Energy Group, LLC, 2013
- Zhvillimi dhe Vlerësimi i Opsioneve të Furnizimit me Energji në Kosovë, DH Infrastructure, The Eörl Bank, 2012
- Projektet e Energjisë në Kosovë, KIPRED, FIQ dhe Instituti GAP, 2011
- Energjia - Një qasje praktike për përfitimet e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në Kosovë, KAS, 2013
- Roli i burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe efikasitet në zhvillimin ekonomik të komunave, KAS 2014
- Raporti për Energjinë në Kosovë, EBC-INCO, 2012
- Vlerësimi i resurseve të erës në Kosovë, NEK Umëeltechnik AG, 2010
- Strategjia e Ngrorjes së Republikës së Kosovës 2011 – 2018
- Sektori i Energjisë në Kosovë - Studimi i tregut të ngrorjes, Banka Botërore, 2007
- Studimi kombëtar rreth efikasitetit të ndërtesave në Kosovë, Banka Botërore, 2013



## ● KU MUND TË MARRIM MË TEPËR INFORMATA?

Procesi i përgatitjes së PLAN-it është koordinuar nga  
Zyra për Planifikim Strategjik e Zyrës së Kryeministrit.

Për më tepër informata mund të kontaktoni në:  
[info@plan-rks.org](mailto:info@plan-rks.org)

[www.plan-rks.org](http://www.plan-rks.org)